

REPUBLICA E KOSOVES/REPUBLIKA KOSOVO/REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA RAHOVEC/OPSTINA ORAHOVAC/MUNICIPALITY RAHOVEC
KABINETI I KRYETARIT TE KOMUNES/KABINET PREDSEDIKA OPSTINE/MUNICIPAL MAYOR CABINET

Njesia Nr./Br./No 02(Kabineti i Kryetarit te Komunes)
Nr./Br./No 130/20 Nr. i faq/Br.str/No.pg 44
Data/Datum/Date 10 / 04 / 2020
RAHOVEC / ORAHOVAC

2020

RAPORT TREMUJOR I PUNËS – ZYRA KOMUNALE PËR KTHIM DHE KOMUNITETE

KOMUNA RAHOVEC

Zyra Komunale për Komunitete dhe Kthim

Brenda tremujorit të parë të vitit 2020, ZKK ka kryer rregullisht punët e saj në fushëveprimin që i takon.

Aktivitetet në periudhën: janar, shkurt, mars

- Në kuadër të koordinimit dhe implementimit të aktiviteteve në bazë të planit vjetor të ZKKK-së, janë realizuar 12 takime të rregullta me stafin e ZKK-së;
- Me qëllim të verifikimit të kërkesave për kthimin e qëndrueshëm të personave të zhvendosur jashtë territorit të Kosovës dhe Komunës së Rahovecit, ZKKK-ja në bashkëpunim me Ministrinë për Komunitete dhe Kthim dhe IOM ka realizuar vizitë zyrtare në Serbi, në kuadër të vizitës "SHIKO-VEZHGO";
- Janë shqyrtuar mbi 12 kërkesa për kthim të familjeve nga Serbia, 8 prej tyre janë aprovuar unanimisht dhe 4 të tjera janë shtyer për ri-shqyrtim në mungesë të kompletimit të të gjitha dokumentacioneve, në bazë të rregullores në fuqi;
- Në kuadër të projektit "PËRMIRËSIMI I INFRASTRUKTURËS NË VENDBANIMET E KOMUNITETEVE JO-SHUMICË NË KOMUNËN E RAHOVECIT" kanë filluar punimet e rrugës në fshatin Xërxë dhe fshatin Çifllak, në kubëzimin e venbanimeve të komuniteteve;
- ZKKK në bashkëpunim me Organizatën IOM, ka nënshkruar vazhdimin e projekteve për mbështetjen e komuniteteve, për projektet kapitale dhe mbështetjen me grante (pajisje) për start-up biznese dhe zgjerim të tyre ndaj komuniteteve jo-shumicë.